

NJOFTIM

"Urdhër mbi ndërprerjen e shortit për periudhën 31.07.2019 - 05.09.2019"

1. Ndërprerjen e shortit elektronik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për periudhën 31.07.2019 – 05.09.2019.
2. Çështjet civile të themelit dhe kërkesat civile që do të depozitohen në gjykatë deri në datën 30.07.2019 do të regjistrohen nga sekretaria gjyqësore në sistem dhe do të hidhen në short rregullisht deri në datën 30.07.2019.
3. Çështjet civile të themelit dhe kërkesat që do të depozitohen në gjykatë nga data 31.07.2019 deri në datën 04.09.2019 do të fillojnë të regjistrohen nga sekretaria gjyqësore në sistem në ditën e parë të punës për administratën gjyqësore (datë 02.09.2019), ose nëse është e mundur edhe më parë dhe do të hidhen në short në shortin e parë që do të zhvillohet në muajin shtator 2019, në datën 06.09.2019.
4. Kërkesat civile me karakter të ngutshëm (sigurime padish, kërkesa për pezullim të veprimeve përmbarimore, etj.), apo kërkesë-paditë që përmbajnë kërkesa të tilla, që do të depozitohen nga data 31.07.2019 deri në datën 06.09.2019, do të regjistrohen nga sekretaria gjyqësore në sistem dhe vetëm kërkesa me karakter të ngutshëm do të shqyrtohet nga gjyqtari i gatshëm sipas urdhërit të miratuar nga Kryetarja për shqyrtimin e kërkesave me karakter të ngutshëm në muajt korrik dhe periudhën 01.08.2019 – 08.09.2019. Me përfundimin e shqyrtimit të kërkesës me karakter të ngutshëm gjyqtari i gatshëm depoziton dosjen në sekretari dhe gjykimi i themelit i kalon gjyqtarit të caktuar me short për çështjet të cilat janë shortuar deri në datë 30.07.2019, ose gjyqtarit që do të caktohet me shortin që do të zhvillohet në shtator 2019 për çështjet e depozituara nga data 31.07.2019 deri në datën 06.09.2019.
5. Kërkesat penale me karakter të ngutshëm që depozitohen në gjykatë në periudhën 01.08.2019 – 08.09.2019 do të shqyrtohen sipas urdhërit të gatishmërisë të miratuar nga Kryetarja për këtë periudhë.
6. Çështjet penale të themelit dhe kërkesat penale që do të depozitohen në gjykatë deri në datën 30.07.2019 do të regjistrohen nga sekretaria gjyqësore në sistem dhe do të hidhen në short rregullisht deri në datën 30.07.2019.
7. Çështjet dhe kërkesat penale që do të depozitohen në gjykatë nga data 31.07.2019 deri në datën 04.09.2019 do të fillojnë të regjistrohen nga sekretaria gjyqësore në sistem në ditën e parë të punës për administratën gjyqësore (datë 02.09.2019) ose nëse është e mundur edhe më parë dhe do të hidhen në short në shortin e parë që do të zhvillohet në muajin shtator 2019, në datën 06.09.2019.
8. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.
9. Një kopje e urdhërit t'u shpërndahet gjyqtarëve, një kopje t'i shpërndahet administratës gjyqësore, një kopje të afishohet për njoftim në ambientet dhe faqen elektronike zyrtare të Gjykatës, si dhe një kopje t'i njoftohet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.